VENDIM
Nr.1117, datë 13.11.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.18, DATË 7.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË, TË SEKTORËVE, QË DO TË MBËSHTETEN, DHE TË MASAVE TË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9917, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4 të vendimit nr.18, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja "a" e "b" ndryshohen si më poshtë vijon:

"a) mbjelljen e pemëve frutore (mollë, dardhë, kumbull, qershi, pjeshkë, lajthi, luleshtrydhe), të ullinjve dhe agrumeve në bllok, jo më pak se 4 dynym, për fermerë individualë, dhe jo më pak se 1 ha, për grup fermerësh, përkatësisht, në vlerat 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale, dhe 300 000 (treqind mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit të tyre.

"b) mbjelljen e vreshtave në bllok, jo më pak se 5 dynym, për fermerë individualë, dhe jo më pak se 1 ha, për grup fermerësh, në vlerën 400 000 (katërqind mijë) lekë/ha.".

b) Pas shkronjës "m" shtohet shkronja "n", me këtë përmbajtje:

"n) pagesën me 5000 (pesë mijë) lekë për kokë, për fermat blegtorale, që mbarështojnë mbi 10 krerë njëthundrakë, por jo më shumë se për 30 krerë.".

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha